



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2083/ 5 prot.

Datë 29.08.2023

V E N D I M

Nr. 820 /2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.08.2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-73075-06-20-2023, me objekt: “Loti nr. 4 - Blerje Shtretër operacioni ortopedinë dhe për neurokirurgjinë në SUT”, me fond limit 16,111,333.33 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 08.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.

Ankimues: “Health & Light” SHPK
Rruga “Themistokli Gërmenji” Nd.11, H.4, Ap.4, njësia Administrative Nr.2, 1010, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Spitali Universitar i Traumës
Rr. “Lord Bajron” Laprakë, Tiranë

Subjekti i interesuar: “O.E.S Distrimed” SHPK
Bulevardi “Bajram Curri” SHPK, pallati Kastrati, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin

dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”

I.4. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21.06.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-73075-06-20-2023, me objekt: “Loti nr. 4 - Blerje Shtretër operacioni ortopedinë dhe për neurokirurgjinë në SUT”, me fond limit 16,111,333.33 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 08.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.

II.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se me datë 08.08.2023 është zhvilluar procedura e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues rezulton, se në datën 21.08.2023, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit

të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

1. "Health & Light" SHPK	8,300,000 lekë	skualifikuar
2. "O.E.S DISTRIMED " SHPK	9,500,000 lekë	kualifikuar
3. "BIOMETRIC ALBANIA " SHPK	10,870,000 lekë	kualifikuar
4. "T R I M E D" SHPK	13,789,000 lekë	skualifikuar

Referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimes "Health & Light" SHPK ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit të tij si më poshtë vijon:

OE Nuk Ploteson kriterin 2.3 Kapaciteti Teknik: 2.3.6 Për të gjithë artikujt e kerkuar sipas tabelës së pasqyruar në këto Dokumente Tenderi (Specifikimet teknike) te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull (pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohet, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

Konkretisht për Artikullin Nr.4 - Shtratë operacioni ortopedike Baza te jete celik inox 304 - specifikimi i kerkuar nuk plotesohet pasi ne katalogun Kataloge te perkthyer Infimed te firmes prodhuese Infimed materiali per shtratin ortopedik eshte ofruar me material celik inoksi por nuk tregon shkallen e kualitetit te celik inoksit 304. Dyshek memory jo me pak se 6cm me veshje antistatike dhe kundra ujit, specifikimi i kerkuar nuk plotesohet pasi ne katalogun Kataloge te perkthyer Infimed te firmes prodhuese Infimed eshte ofruar 5cm. Set me jastike silikoni rrethore per koken, 4 permasa – 1set, specifikimi i kerkuar nuk plotesohet pasi ne katalogun Kataloge te perkthyer Infimed te firmes prodhuese Infimed eshte ofruar ne forme patkoi dhe jo ne forme rrethore si dhe nuk ka te percaktuar qe ofrohen 4 permasa te ndryshme sic eshte kerkuar.

Për Artikullin Nr.5 - Shtratë operacioni për neurokirurgji Baza te jete celik inox 304 - specifikimi i kerkuar nuk plotesohet pasi ne katalogun Kataloge te perkthyer Infimed pasi ne katalogun Kataloge te perkthyer Infimed te firmes prodhuese Infimed materiali per shtratin ortopedik eshte ofruar me material celik inoksi por nuk tregon shkallen e kualitetit te celik inoksit 304. Dyshek memory jo me pak se 6cm me veshje antistatike dhe kundra ujit, specifikimi i kerkuar nuk plotesohet pasi ne katalogun Kataloge te perkthyer Infimed te firmes prodhuese Infimed eshte ofruar 5cm. Fiksuesi kranial te kete referencen optike per neuronavigator, specifikimi i kerkuar nuk plotesohet pasi ne katalogun e paraqitur Kataloge te perkthyer Changzhou Huida te firmes prodhuese Huidamed mungon referenca optike per neuronavigator. Reference optike kraniale per Neuronavigatorin, perfshire krahun e artikular me montim ne fiksuesin kranial -Icope, specifikimi i kerkuar nuk plotesohet pasi nuk eshte ofruar aksesori reference optike si dhe krahun e artikular per montim ne fiksuesin kranial. Ne katalogun Kataloge te perkthyer Changzhou Huida te firmes prodhuese Huidamed eshte markuar artikulli "Navigation adaptor me kod HR07021G" qe nuk ploteson kerkesen as per referencen optike dhe as per krahun e artikular sic jane kerkuar. Set me jastike silikoni rrethore per koken, 4 permasa - 1set, specifikimi i kerkuar nuk plotesohet pasi ne katalogun Kataloge te perkthyer Infimed te firmes prodhuese Infimed eshte ofruar ne forme patkoi dhe jo

ne forme rrethore si dhe nuk ka te percaktuar qe ofrohen 4 permasa te ndryshme sic eshte kerkuar.””

II.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 23.08.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3380 dhe me nr. 2083/2023 prot., datë 23.08.2023 e operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2083/2 datë 24.08.2023, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues nga procedura e prokurimit.

II.6. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se me datë 24.08.2023 është publikuar njoftimi i fituesit paraprak në SPE.

II.7. Me datën 28.08.2023 protokolluar me tonën me nr.2083/3 prot., operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” SHPK ka paraqitur formularin e paraqitjes së argumenteve në cilësinë e subjektit të interesuar në kuptim të nenit 113 të LPP-së, duke respektuar afatet ligjore të paraqitjes së tyre.

II.8. Me shkresën nr. 2143/2 prot, datë 28.08.2023 me objekt: “Vendim për Ankesën nr: A/2023/3380 datë 23-08-2023” protokolluar me tonën me nr. 2083/4 datë 28.08.2023 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, ky i fundit ka argumentuar se: “AK është vënë dijeni për ankesën online me NR. A/2023/3380 datë 23-08-2023 pranë KPP protokolluar me tonën me nr. 2141/1 prot datë 23.08.2023 se OE “Health & Light” SHPK mbi procedurën e prokurimit “E hapur me Nr.reference REF-73075-06-2023 me objekt: “Blerje pajisje mjekësore për SUT” e ndare në lote- Loti nr. 4- Blerje Shtretër operacioni ortopedinë dhe për neurokirurgjinë në SUT, me fond limit; 16,111,333.33 (gjashtëmbëdhjetë milionë njëqind e njëmbëdhjetë mijë treqind e tridhjetë e tre pik tridhjetë e tre) Lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave i ngritur për shqyrtimin e saj pa i hyrë vlerësimit të çështjes ka vlerësuar të ndalet tek respektimi i kërkesave formale (afateve) të ankimimit.

Rrethanat e çështjes

Procedura e prokurimit është hapur për vlerësim ofertash në datën 08.08.2023 dhe është mbyllur vlerësimi në datën 21.08.2023. AK ka dërguar për publikim njoftimin e fituesit paraprak në SPE në datë 23.08.2024 dhe APP e ka publikuar në datë 24.08.2023.

Në nenin 110, pika 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, përcaktohet shprehimisht: 2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin

e vlerësimit klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka konstatuar se ankesa nuk është paraqitur sipas afateve të përcaktuara në nenin 110, pika 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe për këtë arsye Komisioni nuk mori në shqyrtim ankesën e OE “Health & Light” SHPK.

Për sa është argumentuar më sipër, si dhe në kuadër të frymës së transparencës të cilën legjislatori e synon nëpërmjet legjislacionit të prokurimit publik dhe akteve nënligjore për zbatim të tij, Autoriteti Kontraktor, në mbështetje të nenit 110, pika 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 97 pika 2/b të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,

VENDOSI:

Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik OE “Health & Light” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, me Nr. REF-73075-06-20-2023, me objekt “Blerje pajisje mjekësore për SUT” e ndare në lote - Loti nr. 4 - Blerje Shtretër operacioni ortopedinë dhe për neurokirurgjinë në SUT, me fond limit: 16,111,333.33 (gjashtëmbëdhjetë milionë njëqind e njëmbëdhjetë mijë treqind e tridhjetë e tre pik tridhjetë e tre) Lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor Spitali Universitar i Traumës.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në datën 21.06.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-73075-06-20-2023, me objekt: “Loti nr. 4 - Blerje Shtretër operacioni ortopedinë dhe për neurokirurgjinë në SUT”, me fond limit 16,111,333.33 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 08.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.

III.1.1. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se me datë 08.08.2023 është zhvilluar procedura e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.2. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 23.08.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3380 dhe me nr. 2083/2023 prot., datë 23.08.2023 e operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

III.1.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2083/2 datë 24.08.2023, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues nga procedura e prokurimit.

III.1.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se me datë 24.08.2023 është publikuar njoftimi i fituesit paraprak në SPE.

III.1.5. Me shkresën nr. 2143/2 prot, datë 28.08.2023 me objekt: “Vendim për Ankesën nr: A/2023/3380 datë 23-08-2023” protokolluar me tonën me nr. 2083/4 datë 28.08.2023 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, ky i fundit ka argumentuar se: “AK është vënë dijeni për ankesën online me NR. A/2023/3380 datë 23-08-2023 pranë KPP protokolluar me tonën me nr. 2141/1 prot datë 23.08.2023 se OE “Health & Light” SHPK mbi procedurën e prokurimit “E hapur me Nr. Reference REF-73075-06-2023 me objekt: “Blerje pajisje mjekësore për SUT” e ndare në lote- Loti nr. 4- Blerje Shtretër operacioni ortopedinë dhe për neurokirurgjinë në SUT, me fond limit; 16,111,333.33 (gjashtëmbëdhjetë milionë njëqind e njëmbëdhjetë mijë treqind e tridhjetë e tre pik tridhjetë e tre) Lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave i ngritur për shqyrtimin e saj pa i hyrë vlerësimit të çështjes ka vlerësuar të ndalet tek respektimi i kërkesave formale (afateve) të ankimimit.

Rrethanat e çështjes

Procedura e prokurimit është hapur për vlerësim ofertash në datën 08.08.2023 dhe është mbyllur vlerësimi në datën 21.08.2023. AK ka dërguar për publikim njoftimin e fituesit paraprak në SPE në datë 23.08.2024 dhe APP e ka publikuar në datë 24.08.2023.

Në nenin 110, pika 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, përcaktohet shprehimisht: 2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimitklasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka konstatuar se ankesa nuk është paraqitur sipas afateve të përcaktuara në nenin 110, pika 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe për këtë arsye Komisioni nuk mori në shqyrtim ankesën e OE “Health & Light” SHPK. Për sa është argumentuar më sipër, si dhe në kuadër të frymës së transparencës të cilën legjislatori e synon nëpërmjet legjislacionit të prokurimit publik dhe akteve nënligjore për zbatim të tij, Autoriteti Kontraktor, në mbështetje të nenit 110, pika 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 97 pika 2/b të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,

VENDOSI:

Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik OE "Health & Light" SHPK për procedurën e prokurimit "E hapur, me Nr. REF-73075-06-20-2023, me objekt "Blerje pajisje mjekësore për SUT" e ndare në lote - Loti nr. 4 - Blerje Shtretër operacioni ortopedinë dhe për neurokirurgjinë në SUT, me fond limit: 16,111,333.33 (gjashtëmbëdhjetë milionë njëqind e njëmbëdhjetë mijë treqind e tridhjetë e tre pik tridhjetë e tre) Lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor Spitali Universitar i Traumës."

III.1.6. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 "Afatet për ankimim" të Ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikon shprehimisht se: "2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen **brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.**

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. **Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik."**

III.1.7. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikohet shprehimisht se: "1. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik."

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikon shprehimisht se: "1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik."

III.1.8. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit.

Në rastin konkret referuar verifikimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe informacionit të dërguar nga ana e autoritetit kontraktor rezulton, se njoftimi i fituesit paraprak

është publikuar me datë 24.08.2023. KPP vëren, se operatori ekonomik “Health & Light” SHPK, më datë 23.08.2023, ka paraqitur ankesë nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave njëherazi pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, ku kërkon kualifikimin e tij në procedurën e mësipërme të prokurimit, ndërkohë nga verifikimi i sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E), rezulton se në këtë datë (23.08.2023), kur është paraqitur ankesa njëherazi pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, akoma nuk ishte publikuar njoftimi i fituesit paraprak, moment procedural nga i cili fillon afati i ankimimit për operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*”, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Në rastin konkret referuar dokumentacionit të administruar rezulton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë njëherazi pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i cili parashikon se “*2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*”,

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret, afati i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk kishte filluar ende, për sa kohë nuk ishte publikuar njoftimi i fituesit paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike për procedurën e prokurimit objekt - ankimi. Në këtë kuptim KPP gjykon, se ankesa e depozituar nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave njëherazi pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik me numër ankimi elektronik A/2023/3380 datë 23.08.2023 dhe me nr. 2083/2023 prot., datë 23.08.2023, konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*” të ndryshuar parashikohet se: “*Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji*”.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve është i një rëndësie thelbësore, e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë*

prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-73075-06-20-2023, me objekt: “Loti nr. 4 - Blerje Shtretër operacioni ortopedinë dhe për neurokirurgjinë në SUT”, me fond limit 16,111,333.33 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 08.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri